

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Operatori Ekonomik: Komtel Project Engineering SH.P.K. me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	02.11.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **01.11.2021**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Komtel Project Engineering SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME MEKANIZËM BUJQËSOR PËR FERMERË ME PARTICIPIM 80 % - 20 %**, me Numër të prokurimit: **623-21-4135-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-036-1-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** e pabazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Komtel Project Engineering SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME MEKANIZËM BUJQËSOR PËR FERMERË ME PARTICIPIM 80 % - 20 %**, me Numër të prokurimit: **623-21-4135-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-036-1-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **27.10.2021**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **FURNIZIM ME MEKANIZËM BUJQËSOR PËR FERMERË ME PARTICIPIM 80 % - 20 %**, me Numër të prokurimit: **623-21-4135-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-036-1-1-1**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Komtel Project Engineering SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME MEKANIZËM BUJQËSOR PËR FERMERË ME PARTICIPIPIM 80 % - 20 %**, me Numër të prokurimit: **623-21-4135-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-036-1-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **27.10.2021**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **01.11.2021**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE TË KËRKESËS

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit ka trajtuar këtë procedurë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Autoriteti Kontraktues: KOMUNA E RAHOVECIT ka shpërblyer me kontratë Operatorët Ekonomik me çmim i cili është ma i leverdishëm për Autoritetin Kontraktues, në bazë të Nenit 2.5:

Ndarja ne Lote	2.5	Ndarja ne Lote: Po ☒ Objekti i kontratës është i ndare në 6 pjesë (lote). Tenderuesi mund të paraqesë tender për: ☒ Të gjitha pjesët Secila pjesë e lot-it është e shënuar në specifikacionet teknike, shih Aneksin 1. Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues është: 2 Në rast se Tenderuesi ofron çmimin më të ulët në më shumë se 1 LOT atëherë ai do të shpërblehet me kontratë për LOTIN që i cili është ma i leverdishëm për Autoritetin Kontraktues, dhe ne rast te mos pranimit te shume ofertave, vlen shembulli i RrUOPP-së, (Shembull: Ndarja në Lote: 7 Lot-e)
----------------	-----	--

Ju si Operator Ekonomik jeni shpërblyer me kontratë për LOT 1

Ndërsa për LOT 2, 3, 4, 5 jeni njoftuar me formular: *B46 Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm*, në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik.

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Me respekt:
Zyra e Prokurimit
Komuna e Rahovecit